



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT TË INDUSTRIËS DHE
ENERGJISË**

Nr. 4088/prot.

Tiranë, më 16.3.2018

Lënda: Njoftim për fillim procedurash revokimi të lejes nr.1109, datë 06.12.2007.

SHOQËRISË “MINERAL - INVEST” SHPK

Godina Dy Katëshe e Gjeologjisë, Bajram Curri, Tropojë, Qarku Kukës

**Për dijeni: AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE
Bulevardi “Bajram Curri”, Blloku “Vasil Shanto”, Tiranë**

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE
EMERGJENCAT NË MINIERA
Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë**

Shoqëria “Mineral Invest” sh.p.k është zotëruese e lejes minerare të shfrytëzimit nr.1109, datë 06.12.2007, për mineral kromi, në objektin “Përroi i Pirrës”, Tropojë.

Nga struktura përgjegjëse AKBN me shkresën nr.4337, datë 22.05.2017, protokolluar në Ministrinë e Energjisë dhe Industrisë me nr.4087, datë 23.05.2017, dhe shkresën nr.7198, datë 16.10.2017, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me nr.888, datë 17.10.2017, është propozuar revokimi i lejes minerare të shfrytëzimit nr.1109, datë 06.12.2007, për mineral kromi, në objektin “Përroi i Pirrës”, Tropojë, për arsye se nuk janë kryer pagesat e rehabilitimit vjetor, përcaktuar sipas pikës 5, të nenit 31, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Gjithashtu është ndërprerë puna për më shumë se një vit, duke mos respektuar kërkesat e nenit 18, gërma “d” dhe germa “dh”, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, “Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Leja juaj është dhënë me Ligjin nr.7796, datë 17.02.1994, "Minerar të Shqipërisë", të ndryshuar, që është shfuqizuar me ligjin nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Sipas nenit 57, pika 2 dhe 3, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, përcaktohet shtrirja e efekteve edhe për lejet e dhëna përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore për revokim është i mbështetur në germën "c" dhe në germën "ç", të pikës 1, të nenit 47, (neni që përcakton shkeljet ligjore për të cilat një leje revokohet), të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Për sa më sipër, në zbatim të nenit 48, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, **ju njoftojmë fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare të shfrytëzimit nr.1109, datë 06.12.2007, për mineral kromi, në objektin "Përroi i Pirrës", Tropojë, që shoqëria juaj zotëron.**

Ju bëjmë të ditur se, pas një periudhe 30 ditore nga ky njoftim, do të merret vendimi për revokimin e lejes shfrytëzimit nr.1109, datë 06.12.2007, për mineral kromi, në objektin "Përroi i Pirrës", Tropojë.

Në zbatim të nenit 49, të ligjit nr.10304, datë 15.07.2010, "Për sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, duhet të rehabilitoni zonën e shfrytëzimit në të cilën keni ushtruar aktivitet minerar.

Duke ju falënderuar për mirëkuptimin.

MINISTRI

DAMIAN GJIKNURI

NË MUNGESË DHE ME POROSI

ZËVENDËSMINISTRI

